

**AUTORITETI SHETËROR PËR INFOMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

**(ASIG)**

**PLANI**

**I VEPRIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT 2018 – 2020**

**Janar 2018**

Miratohet:

**Lorenc ÇALA**

*Drejtor i Përgjithshëm*





## Përmbajtje

### Plani i Veprimit kundër Korrupsionit 2018 – 2020, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)

I –Hyrje .....	1
II- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor .....	1
III- Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2018 - 2020.....	2

## I. HYRJE

Korrupsioni është një fenomen mjaft shqetësues dhe prezent në shoqërinë shqiptare. Ky fenomen prek ndjeshëm ekonominë, jetën sociale si dhe atë politike, duke penguar zhvillimin e vendit dhe përpjekjet e Shqipërisë për ecurinë e qëndrueshme dhe pozitive, në zbatim të rekomandimeve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Së fundmi rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE, kanë patur në fokusin e tyre kryesisht luftën ndaj korrupsionit. Ndërkohë, një ndër 5 prioritet kyçe të Udhërrëfyesit të Raport Progresit për hapjen e negociatave të anëtarësimin, është pikërisht “lufta e mëtejshme kundër korrupsionit”.

Në këto rrethana, si dhe në kuadër të masave që qeveria shqiptare ka ndërmarrë duke luftuar në mënyrë drastike dhe efikase korrupsionin, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, ka hartuar Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit 2018-2020.

Ky plan pasqyron objektivat që ASIG synon të realizojë në kuadër të politikave për forcimin e luftës ndaj korrupsionit.

## II. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), është institucion publik qendror, i krijuar me ligjin 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

ASIG, zbaton politikën kombëtare për infrastrukturën e informacionit gjeohapësinor. Një nga objektivat kyç të ASIG-ut është ndërtimi i Gjeoportali Kombëtar, i cili tashmë është ndërtuar dhe aksesohet nga institucionet publike, sipërmarrjet private si dhe qytetarët. Gjeoportali Kombëtar është një "derë" e cila i mundëson përdoruesve profesionistë, por dhe publikut të kërkojnë, shikojnë dhe aksesojnë në mënyrë shumë të thjeshtë të dhënat gjeohapësinore dhe shërbimet online të vëna në dispozicion nga institucionet e ndryshme shtetërore.

Ky Gjeoportali është një hap shumë i rëndësishëm në kuadër të Qeverisjes të Hapur (OGP), që në thelb ka politikën e të dhënave të hapura për qytetarët, duke u ofruar shërbime larg burokracisë dhe afër cilësisë. Gjeoportali Kombëtar shërben për bashkëpunim ndër-institucional në kuadër të eficiencës në shërbim të qytetarit. Po ashtu është një hap i nevojshëm në ngritjen e Infrastrukturës së të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI), një prioritet në kuadrin e-Government dhe afrimit të Shqipërisë me Direktivën INSPIRE.

## PLANI I VEPRIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT 2018 -2020

Objektivi	Aktiviteti	Produkti	Treguesit e zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucione bashkëpunuese	Afati kohor	Kosto e vlerësuar e produktit	Total
A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	A.1.1	Hartimi i Programeve të Transparencës sipas ligjit të ri për të drejtën e informimit.	1.Publikimi i Programeve të Transparencës në faqen zyrtare të ASIG <a href="http://www.asig.gov.al">www.asig.gov.al</a> në internet.	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor - ASIG	-	2018-2020	Nuk ka kosto	-
	A.1.2	Krijimi i strukturave të nevojshme për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit	1.Caktimi i personit pranë institucionit për zbatimin e ligjit. 2.Publikim i kontakteve të koordinatorit.	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor - ASIG	-	2018-2020	Nuk ka kosto	-
	A.1.3	Zbatimi i plotë i ligjit për konsultimin publik. Krijimi i strukturave të nevojshme për zbatimin e ligjit për konsultimin publik. Rritje e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në proceset politikëbërëse dhe	1. Publikim i projektakteve për konsultim publik. 2. Publikim I nr. të akteve të miratuara për të cilat është kryer procesi i konsultimit sipas dispozitave përkatëse ligjore. 2. Publikim i Regjistrit të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve".	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor - ASIG	-	2018 - 2020	Nuk ka kosto	-

		vendimmarrëse të institucionit.	3.Publikim i kontakteve të koordinatorit.					
	A.1.4	Rritja e transparencës në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe rekrutimeve.	Bërje publike e vendeve vakante në faqen zyrtare të institucionit.	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor - ASIG	DAP	2018 - 2020	Nuk ka kosto	-
A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	A.2.1	Bërja publike e buxhetit dhe procedurave të prokurimit publik në websit-in e Institucionit	1.Publikim i Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik. 2. Publikim i Regjistrit të Realizimeve të Prokurimit Publik. 3. Publikim i Raporteve të Monitorimit për Zbatimin e Buxhetit. 4.Bërja publike e buxhetit të institucionit dhe të procedurave të prokurimit publik; 5.Publikim i Raporteve të Auditit.	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor – ASIG,		2018-2020	Nuk ka kosto	-
A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	A.3.1	Krijimi i gjeo-portalit me informacion dhe akses të saktë në hartat topografike, ortofoto, hartat e kufirit, hartat treguese të pasurive të paluajtshme dhe harta të vlerave të pronës, ndarjet administrative , kadastrën e pronave të paluajtshme, adresari , zonat mjedisore të	1.Website i aksesueshëm; Asig garanton aksesin e publikut dhe subjekteve të interesuara në përputhje me dispozitat e ligjit 72/2012. 2. Numri i shërbimeve të ofruara; 3. Numri i kërkesave për informacion të pranuar; 4. Nr i hartave të hedhura në sistemin dixhital 5. Publikim i "Udhëzimit Teknik të Detajuar mbi Profilin e Metadatave për Krijuesit dhe Përdoruesit".	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor – ASIG	-	2018-2020	*Krijimi i Gjeoportali t Kombetar është donacion, ndërsa mirëmbajtja e tij do të bëhet nga AKSHI, në bazë të lejgislacionit në fuqi. Kosto-ja e	-

		mbrojtura, Census 2011, Orto Imazheri 2007.					miratuar është 15.000.000 për 4-vite.	
A.5 Deklarimi i pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	A. 5.1	<p>1.Krijimi i një regjistri të posaçëm për rastet e konfliktit te interesave në institucion.</p> <p>2. Ngritja e autoriteteve përgjegjëse për të zbuluar, trajtuar dhe zgjidhur konfliktin e interesave rast pas rasti.</p> <p>3. Zbatim rigoroz i legjislacionit në fuqi mbi deklarin dhe kontrollin e pasurive.</p> <p>4. Monitorim i vazhdueshëm i ndryshimeve që mund të pësojë legjislacioni në fjalë, me qëllim realizimin sa më të sukseshëm dhe në kohë të procesit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive.</p> <p>5.Trajnim i punonjësve mbi procesin e prokurimit publik dhe rasteve të konfliktit të interesit.</p>	<p>1.Nr. i rasteve të deklaruara.</p> <p>2.Numri i rasteve konkrete të evidentuara.</p> <p>3. Nr. i personave që trajtojnë çështje të konfliktit të interesave.</p> <p>4. Modulet mbi konfliktin e interesit dhe prokurimet.</p> <p>5. Plotësim i deklaratave mbi konfliktin e interesit në proceset e prokurimit publik.</p> <p>6.Plotësim nga ana e çdo punonjësi brenda 30-ditëve nga emërimi i tij, të Autorizimit mbi kontrollin e konfliktit të interesit.</p> <p>5.Nr. i trajnimeve.</p> <p>6. Nr. i personave të trajnuar.</p>	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor – ASIG	ILDKPKI	2018-2020	Nuk ka kosto	-

A.7 Auditim dhe inspektim i brendshëm.	A 7.1	1.Kryerje e Auditimit periodik për sistemin e kontrollit të brendshëm dhe përpuethshmërinë financiare nga struktura të specializuara. 2. Kërkesë pranë MFE për kryerjen e auditit. 3.Zbatim i marrëveshjes të lidhur me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për kryerjen e procesit të auditimit të brendshëm. 2 Krijim dhe përditësim i Regjistrit të Riskut për ASIG.	1.Publikim i raportit të Auditit.  2. Evidentim i riskut dhe marrja e masave parandaluese	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor – ASIG  Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor – ASIG	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	2018-2020	Nuk ka kosto	-
C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	C2.1	Publikimi online i të gjitha akteve nënligjore që parashikojnë procedurat e trajtimit të ankesave dhe afatet.	1.Adresa web e aksesueshme 2.Publikim në faqen zyrtare <a href="http://www.asig.gov.al">www.asig.gov.al</a> , të kontakteve ku publiku mund të denoncojë rastet e korrupsionit nëse ka. 3.Publikim i modeleve të ankesave.	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor – ASIG	-	2018-2020	Nuk ka kosto	-